

Direct Dials sh.p.k.

Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA:

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE:

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6–15

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	4	2,821,453
Të tjera llogari të arkëtueshme	5	2,660,696
Shpenzime të shtyra	6	1,428,150
Total aktive afatshkurtra		6,910,299
Aktivët afatgjatë		
Aktive afatgjatë materiale	7	6,912,756
Total aktive afatgjatë		6,912,756
Total aktive		13,823,055
DETYRIMET		
Detyrime afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare	8	666,313
Detyrime tatimore	9	1,024,857
Total detyrime afatshkurtra		1,691,170
Detyrime afatgjatë		
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	10	25,047,564
Total detyrime afatgjatë		25,047,564
Totali i detyrimeve		26,738,734
KAPITALI		
Kapitali i nënshkruar	11	109,900
Fitimi/humbja e vitit		(13,025,579)
Total kapitali		(12,915,679)
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		13,823,055

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Direct Dials Sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit		-
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	12	351,237
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(6,278,984)
1) Të tjera shpenzime	13	(6,278,984)
Shpenzime të personelit	14	(6,800,251)
1) Paga dhe shpërblime		(5,990,557)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(809,694)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	(297,581)
Të ardhura të tjera		-
Shpenzime financiare		-
Fitimi/ humbja para tatimit		(13,025,579)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	15	-
Fitimi/ humbja e vitit		(13,025,579)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(13,025,579)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Direct Dials sh.p.k.

(Vlerat janë në Lekë)

**Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Kapitali i nënshkruar	Fitim /(humbja) e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 08 gusht 2019	-	-	-
Fitimi / Humbja e vitit	-	(13,025,579)	(13,025,579)
Emetimi i kapitalit të nënshkruar	109,900	-	109,900
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	109,900	(13,025,579)	(12,915,679)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 janë aprovuar nga administratori i Direct Dials sh.p.k. më 24 mars 2020 dhe janë firmosur si më poshtë:

Z. Oded Segev
Administrator



Mazars Shpk

Mazars Shpk
Hartues i Pasqyrave Financiare

M MAZARS
Rr. Emin Duraku, Pall "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Direct Dials Sh.p.k.*(Vlerat janë në Lekë)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

Shënime	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Flukset i Mjeteve Monetare nga aktivitetet operative	
Fitim/ Humbja e vitit	(13,025,579)
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:	
Shpenzimet financiare jomonetare	(349,964)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	297,581
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>	
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(2,660,696)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	1,691,170
Rritje/(rënie) në parapagime dhe shpenzime të shtyra	(1,428,150)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(15,475,638)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata material	(7,210,337)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(7,210,337)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	109,900
Hua të arkëtuara	25,454,372
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	25,564,272
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	2,878,297
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	-
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(56,844)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	2,821,453
4	

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Direct Dials sh.p.k është themeluar më 05 gusht 2019 dhe është regjistruar më 08 gusht 2019 në Regjistrin e Shoqërive me akt themelimi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është: të kryej cdo aktivitet tregtar të lejuar nga legjislacioni Shqiptar, vecanërisht shërbime qendre të thirrjeve telefonike (call center).

Administrator i Shoqërisë është Z. Oded Segev.

Shoqëria është e regjistruar pranë degës së Tatim Taksave në Tiranë me NIPT L92008017M. Selia qendrore e saj është në: Bulevardi "Gjergj Fishta", Qendra e Biznesit Alpas, ndertesa nr. 146, Tiranë.

Numri punonjësve më 31 dhjetor 2019 ishte 32 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr. 25/2018, datë 10 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pamundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.2 Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3 Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019
Euro/LEK	121.77
USD/LEK	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiar të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerrtet nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiar të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat kontabël (vazhdim)**3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25%
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 5 %.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Direct Dials sh.p.k.
 Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
 (Vlerat janë në Lekë)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	2,821,453.3
Mjete monetare në arke	-
	<u><u>2,821,453</u></u>

5. Llogari të arkëtueshme të tjera

Llogaritë e arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
TVSH	2,168,667
Garanci qiraje	130,368
Të Arkëtueshme nga Frenklind Prifti	361,661
	<u><u>2,660,696</u></u>

6. Shpenzime të shtyra

Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime të periudhave të ardhme për përshtatje ambjentesh	859,055
Të tjera shpenzime të periudhave të ardhme	569,095
	<u><u>1,428,150</u></u>

7. Aktivet afatgjata materiale

	<u>Mobilje dhe pajisje zyre</u>	<u>Paisje kompjuterike</u>	<u>Të tjera</u>	<u>Totali</u>
Gjendja më 8 gusht 2019	-	-	-	-
Shtesa	1,133,328	4,715,043	1,361,966	7,210,337
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,133,328	4,715,043	1,361,966	7,210,337
<i>Amortizimi I akumuluar</i>				
Gjendja më 8 gusht 2019	-	-	-	-
Amortizimi i vitit	34,789	221,198	41,594	297,581
Gjendja më 31 dhjetor 2019	34,789	221,198	41,594	297,581
<i>Net Book Value</i>				
Gjendja më 8 gusht 2019	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2019	1,098,539	4,493,845	1,320,372	6,912,756

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Furnitorë vendas	666,313
	<u>666,313</u>

9. Detyrimet tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	636,879
Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi	272,950
Tatimi në burim	115,028
	<u>1,024,857</u>

10. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura

Detyrime afatgjata ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Financim nga ortakut Pearl Alpha Funding	25,047,564
	<u>25,047,564</u>

11. Kapitali

Kapitali i shoqërisë Direct Dials sh.p.k është 109.900 lekë më 31 dhjetor 2019.

Humbja e vitit është 13,025,579 Lekë.

12. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhura të tjera nga aktiviteti i shfrytëzimit më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Humbje nga këmbimet valutore	(60,846)
Fitim nga këmbimet valutore	412,083
	<u>351,237</u>

12. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruara në FDP e TVSH-së	-
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	-
	-
Shitje mallrash	-
Shërbime	-
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar në shitje në FDP	-
	-
Fitime nga këmbimet valutore	412,083
Total të ardhura të deklaruar në FDP-në e Tatim Fitimit	412,083

13. Shpenzime të tjera

Shpenzimet e tjera më 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të tjera	1,372,166
Konsulencë juridike	1,205,410
Shpenzime pritje-përcjellje	995,539
Pajisje ndihmëse	696,454
Qira zyre	613,494
Konsulencë ekonomike	391,720
Shpenzime rekrutimi	129,273
Blerje të ndryshme, kancelari etj	124,666
Shërbim pastrimi	119,167
Shpenzime bankare	112,673
Shërbim interneti	107,631
Shpenzime për përshtatje ambjentesh	107,382
Prime Sigurimi	105,981
Shërbim konsulte rekrutim stafi	89,767
Shërbim IT	64,589
Utilitete	35,822
Shërbime administrative	7,250
	6,278,984

14. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	5,990,557
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	809,694
	<u><u>6,800,251</u></u>

15. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Fitimi para tatimit	(13,025,579)
Shpenzime të panjohura (si më poshtë)	2,514,956
Shpenzime pritje & përcjellje	995,539
Shpenzime pa faturë të rregullt tatimore	1,519,417
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(10,510,623)
Tatim fitimi	-
Fitimi i vitit	(10,510,623)

16. Transaksionet me palët e lidhura

Transaksionet me palët e lidhura paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Bilanci kontabël:	
Pearl Alpha Funding	25,047,564
	<u><u>25,047,564</u></u>

17. Angazhime dhe pasiguri*Çështje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

18. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.